

VENDIM
Nr.116, datë 22.2.2006

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT DITOR TË USHTARAKËVE SHQIPTARË,
NË PËRBËRJE TË SHTABIT TË SEEBRIG-UT, NË MISIONIN E MBËSHTETJES SË
PAQES (ISAF), NË AFGANISTAN, TË DREJTUAR NGA NATO-JA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të aktit normativ nr.5, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin e personelit ushtarak shqiptar, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, në misionin e mbështetjes së paqes (ISAF), në Afganistan të drejtuar nga NATO, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakët shqiptarë, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, në misionin e mbështetjes së paqes (ISAF), në Afganistan, të drejtuar nga NATO-ja, për ditët e qëndrimit në mision në Afganistan, përveç pagës mujore, të marrin, për vështirësi shërbimi, një shpërblim ditor në masën 60 (gjashtëdhjetë) USD.

2. Efektet financiare, në masën 10 206 000 (dhjetë milionë e dyqind e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, zëri “Mallra dhe shërbime”, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha